

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR
MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET
PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në garantimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil dhe mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil në institucionet publike;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionit mbikëqyrës të këtij institucioni në forcimin e ligjshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe qëndrueshmërisë së administratës publike;

Duke vlerësuar veprimtarinë e institucionit në drejtim të evidentimit të problematikave që lidhen me zbatimin e procedurave të rekrutimit, masave disiplinore dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në shërbimin civil;

Duke vlerësuar kontributin e institucionit në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të institucioneve publike për detyrimet që burojnë nga legjislacioni i shërbimit civil dhe forcimit të standardeve të administrimit publik;

Duke vlerësuar bashkëpunimin institucional me Departamentin e Administratës Publike, njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera publike në funksion të përmirësimit të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil;

Duke vlerësuar rëndësinë e reformës në administratën publike në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies administrative;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2025 dhe vlerëson:

Vijimin e ushtrimit të funksionit mbikëqyrës për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Evidentimin e problematikave që lidhen me procedurat e rekrutimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe administrimit të marrëdhënieve të shërbimit civil.

Vijimin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqftues dhe evidentimin e problematikave të konstatuara gjatë këtyre proceseve.

Angazhimin në drejtim të forcimit të ligjshmërisë në procedurat disiplinore dhe monitorimit të zbatimit korrekt të masave administrative në institucionet publike.

Bashkëpunimin institucional me Departamentin e Administratës Publike dhe institucionet e tjera përgjegjëse në funksion të përmirësimit të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil.

Evidentimin e nevojës për forcimin e planifikimit të burimeve njerëzore dhe reduktimin gradual të vendeve vakante në administratën publike.

Vijimin e rekomandimeve për përmirësimin e procedurave administrative dhe forcimin e standardeve të administrimit të shërbimit civil.

Angazhimin në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies administrative në institucionet pjesë e shërbimit civil.

Evidentimin e nevojës për forcimin e kapaciteteve profesionale të administratës publike dhe zhvillimin e mëtejshëm të trajnimeve për nëpunësit civilë.

Kontributin e institucionit në forcimin e administratës publike profesionale, të qëndrueshme dhe të bazuar në meritë, në përputhje me standardet e reformës së administratës publike dhe procesit të integritetit evropian.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të zhvillojë dhe konsolidojë mekanizma të monitorimit të vazhdueshëm dhe në kohë reale për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura pjesë e sistemit të shërbimit civil.

2. Të përfundojë ngritjen dhe funksionalizimin e platformave digjitale për monitorimin e treguesve të shërbimit civil, raportimin e shkeljeve, administrimin e ankesave dhe identifikimin

e hershëm të rasteve të mosrespektimit të legjislacionit, duke mundësuar raportimin automatik të të dhënave nga institucionet publike.

3. Të hartojë dhe publikojë një raport vjetor analitik për nivelin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, duke evidentuar institucionet me shkelje të përsëritura, masat e ndërmarra, rezultatet e arritura dhe rekomandimet përkatëse për institucionet përgjegjëse.

4. Të përmbyllë hartimin e raportit analitik për kostot financiare që i shkaktohen buxhetit të shtetit nga emërimet në kundërshtim me ligjin dhe nga vendimet gjyqësore të paekzekutuara për institucionet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura pjesë e sistemit të shërbimit civil.

5. Të përdorë në mënyrë të plotë mekanizmat ligjorë për rastet e moszbatimit ose zbatimit të pjesshëm të vendimeve të Komisionerit, duke forcuar metodologjinë e mbikëqyrjes dhe duke rritur efektivitetin e kontrollit administrativ.

6. Të rrisë efektivitetin e mbikëqyrjes përmes zgjerimit të inspektimeve të bazuara në analizën e riskut dhe identifikimin e sektorëve apo institucioneve me problematika të përsëritura në administrimin e shërbimit civil duke propozuar masa konkrete për parandalimin e përsëritjes së tyre.

7. Të marrë pjesë aktive në proceset e reformimit të administratës publike dhe në diskutimet për ndryshimet ligjore që prekin sistemin e shërbimit civil, duke paraqitur propozime konkrete për përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit.

8. Të finalizojë hartimin dhe miratimin e strategjisë afatmesme të institucionit për periudhën 2026–2030, duke përcaktuar objektiva të matshëm dhe tregues performance për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse.

9. Të forcojë rolin e institucionit në unifikimin e praktikave administrative dhe hartimin e metodologjive standarde, me qëllim reduktimin e interpretimeve të ndryshme dhe garantimin e zbatimit të njëtrajtshëm të legjislacionit në të gjitha institucionet.

10. Të intensifikojë monitorimin e procedurave të rekrutimit në administratën publike, përfshirë monitorimin periodik të praktikave të ndjekura nga Departamenti i Administratës Publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim rritjen e efikasitetit të procedurave dhe reduktimin e vendeve vakante.

11. Të vijojë monitorimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë, veçanërisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke evidentuar rastet e përsëritura të moszbatimit ose vonesave në ekzekutim, ndikimin financiar që ato sjellin për buxhetin e shtetit, si dhe duke forcuar bashkëpunimin institucional për garantimin e zbatimit efektiv dhe në kohë të tyre.

12. Të hartojë një raport përmbljedhës për problematikën që lidhen me përfundimin e marrëdhënieve të shërbimit civil për shkak të ligjit, përfshirë rastet e daljes në pension, duke evidentuar ndikimin e tyre në administrimin e burimeve njerëzore në institucionet publike.

13. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe institucionet e pushtetit vendor të organizojë programe trajnimi, aktivitete ndërgjegjësuere dhe shkëmbim praktikash më të mira për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.

14. Të konsolidojë monitorimet tematike para dhe pas periudhave zgjedhore, duke zbatuar metodologji të posaçme mbikëqyrjeje dhe duke marrë masa paraprake për informimin e institucioneve lidhur me detyrimet ligjore të nëpunësve civilë gjatë proceseve zgjedhore, me qëllim garantimin e paanshmërisë politike dhe profesionalizmit të administratës publike.

15. Të kryejë një analizë të plotë për efektivitetin e mekanizmave aktualë të shqyrtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën e shërbimit civil, duke paraqitur pranë Kuvendit rekomandime konkrete për përmirësime ligjore dhe institucionale.

16. Të vijojë të kryejë vlerësime periodike të strukturës organizative, burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale të Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, duke paraqitur pranë institucioneve përgjegjëse propozime për riorganizim dhe fuqizim institucional sipas nevojave të evidentuara.

17. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, institucionet e pushtetit vendor, institucionet e pavarura dhe ato të krijuara me ligj, të fillojnë punën për unifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, duke evidentuar pengesat ekzistuese dhe duke propozuar masa konkrete ligjore për harmonizimin e tyre, me qëllim garantimin e lëvizshmërisë ndërinstitutionale dhe administrimin e njëtrajtshëm të burimeve njerëzore në shërbimin civil.

18. Të vijojë bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet homologe, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe përvetësimin e standardeve më të mira në fushën e mbikëqyrjes së shërbimit

19. Të forcojë transparencën dhe llogaridhënien institutionale përmes publikimit proaktiv dhe të përditësuar të informacionit publik, fuqizimit të kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për të drejtën e informimit, si dhe promovimit të standardeve të të dhënave të hapura për të garantuar aksesueshmëri, ripërdorim dhe komunikim efektiv me publikun.

20. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë të standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 30.6.2026

KRYETAR
Niko Peleshi